

2022

UDHËZUES PRAKTIK

**ZBATIMI I TEKNOLOGJISË NË
PROCEDURËN E NDËRMJETËSIMIT
NDËRMJETËSIMI ONLINE**



Alternative Dispute Resolution Center
Mediation Center Mitrovica



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Udhëzues Praktik

Zbatimi i Teknologjisë në Procedurën e Ndërmjetësimit - Ndërmjetësimi Online

Autor:

Besim M. Kajtazi, Ndërmjetësues i licencuar

Kontribues/e:

Zana Sylja

Besnik Uka

Publikuar në kuadër të projektit *“Drejt lehtësimit të qasjes në drejtësi në veri të Kosovës”* nga:



Alternative Dispute Resolution Center
Mediation Center Mitrovica


Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (“ADRC”) është organizatë jo-qeveritare me qendër në Mitrovicë, puna e së cilës është e përqendruar në ofrimin e një platforme për angazhim të përbashkët ndëretnik dhe mirëkuptim të ndërsjellë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe paqes dhe zhvillimin e komuniteteve në rajonin e Mitrovicës. ADRC gjithashtu është e specializuar në fushën e ndërmjetësimit dhe ka mbështetur dhe mbështet fuqizimin e sistemit të drejtësisë në veçanti në rajonin e Mitrovicës, por dhe më gjërë.

Mbështetur nga:




Përmbajtja e këtij publikimi mbetet përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton apo përfaqëson në asnjë mënyrë pikëpamjet e National Endowment for Democracy (“NED”). Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në ndonjë formë dhe/apo mënyrë pa lejen e publikuesit.

Mitrovicë, nëntor 2022



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	1
I. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR NDËRMJETËSIMIN ONLINE.....	3
Ndërmjetësimi online.....	3
Përdorimi i teknologjisë në ndërmjetësimin online.....	5
Parimet e ndërmjetëimit online	7
Pjesëmarrësit në procedurën e ndërmjetëimit online	9
Të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedurën e ndërmjetëimit online	10
Kohëzgjatja dhe shpenzimet e procedurës së ndërmjetëimit online	12
Aftësimi profesional dhe promovimi i ndërmjetëimit online	17
II. HAPAT NË PROCEDURËN E NDËRMJETËIMIT ONLINE.....	18
Pajtimi i palëve për zhvillimin e ndërmjetëimit online	18
Nënshkrimi i marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetëimit online	19
Seancat e ndërmjetëimit online.....	19
Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar në ndërmjetësimin online	20
Ndërprerja dhe përfundimi i procedurës së ndërmjetëimit online.....	21
Efekti juridik i marrëveshjes së arritur në ndërmjetësimin online	22
III. LISTA E BURIMEVE.....	23



HYRJE

Ndërmjetësimi, është procedurë jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve apo mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës, në të cilin palët e përfshira në kontest apo mosmarrëveshje për zgjedhin një ose më shumë ndërmjetësues/e për t'u ndihmuar atyre në arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, përmes pajtimit të të dyja palëve dhe rrjedhimisht lidhjes së marrëveshjes për procedurën e ndërmjetësit, në pajtim me kushtet e përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (Në tekstin e mëtejme do t'i referohemi: Ligji për Ndërmjetësim).¹

Marrëveshja e ndërmjetësit e lidhur në procedurën e ndërmjetësit (Në tekstin e mëtejme do t'i referohemi: Marrëveshja e ndërmjetësit), konsiderohet ujdë gjyqësore dhe është dokument i përmbarueshëm, pra është i detyrueshëm për palët. Prishja apo anulimi i marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, bëhet vetëm me procedurë gjyqësore.


Procedura e ndërmjetësit zhvillohet në bazë të vullnetit të lirë të palëve dhe me pjesëmarrjen fizike të tyre dhe ndërmjetësuesit/es të angazhuar në procedurë. Por, procedura e ndërmjetësit mund të zhvillohet edhe përmes teknologjisë, pra në mënyrë virtuale pa prani fizike (Në tekstin e mëtejme do t'i referohemi: Ndërmjetësimi online).

Neni 11.4 i Ligjit për Ndërmjetësim ka dhënë mundësinë që palët e përfshira në procedurën e ndërmjetësit, të jenë të pranishme edhe përmes teknologjisë dhe kjo është edhe një ndër risitë e këtij ligji i cili është në fuqi që nga shtatori i vitit 2018.² Megjithatë, Ligji për Ndërmjetësim nuk ka qartësuar nëse kjo i referohet vetëm seancave të ndërmjetësit apo tërë procedurës së ndërmjetësit, përfshirë edhe nënshkrimin të marrëveshjeve të ndërmjetësit.³ Njëkohësisht, edhe aktet nënligjore në zbatim të Ligjit për Ndërmjetësim, kanë bërë përkrahje të Nenit 11.4 dhe nuk kanë shpjeguar mënyrën e përdorimit të teknologjisë në procedurën e ndërmjetësit. Po ashtu, Ligji për Ndërmjetësim nuk ka dhënë ndonjë definicion për termin "teknologji" përkundër faktit që ky term përfshin një koncept të gjerë për të cilin fjalorë dhe studiues të ndryshëm kanë dhënë shumëllojshmëri përkufizimesh. Njëkohësisht, përdorimi i termit "teknologji" ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme përgjatë dekadave si dhe dallon jo rrallë edhe kuptimi i këtij termi në shkencë të ndryshme dhe në gjuhë të ndryshme. Rrjedhimisht sipas kornizës ligjore në fuqi për ndërmjetësimin nuk kemi ndonjë përkufizim të saktë për këtë term. Shtu këtu faktin që nënshkrimi elektronik, relevant për pjesën e marrëveshjeve të ndërmjetësit, akoma është i pazbatueshëm, dhe këto në tërësi

¹ Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 20 gusht 2018). Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, është shfuqizuar Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (Gazeta Zyrtare, Nr. 41, 01 nëntor 2008)

² Shih Ndërmjetësimi në Kosovë: Vështrim dhe Rekomandime, Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRRC), 2021, f. 24-29

³ Po aty, f. 27



ndikojnë në ndërmjetësimin online në Republikën e Kosovës të mbetet akoma pamjaftueshëm i qartë dhe/apo i zbatueshëm.


Udhëzuesi Praktik “Zbatimi i Teknologjisë në Procedurën e Ndërmjetësit - Ndërmjetësimi Online” është materiali i parë konkret dhe praktik dhe ndër kontributet më të rëndësishme deri më tani, në ndihmë të përdorimit të teknologjisë në ndërmjetësim apo ndërmjetësimin online në Republikën e Kosovës. Udhëzuesi është përgatitur duke ju përmbajtur në përpikëri dispozitave të legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin si dhe legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me nënshkrimin elektronik dhe shërbimet tjera elektronike. Për me tej, ky udhëzues po ashtu i referohet edhe praktikave të mira.

Në vijim të gjithë asaj që u cek më lartë, qëllimi i këtij udhëzuesi praktik është të kontribuojë në funksionimin e duhur, të drejtë, të harmonizuar dhe të besueshëm të ndërmjetësit online, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si i tillë ndihmon në fuqizimin e sistemit të ndërmjetësit dhe të qasjes më të aplikueshme dhe efikase në drejtësi.

Udhëzuesi ka për synim të informojë dhe të pajisë me njohuri publikun e gjerë, por në veçanti dhe në mënyrë primare i drejtohet ndërmjetësuesve të vendit dhe Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës (“ONDK”), institucioneve përkatëse (si Ministria e Drejtësisë “MD”, Këshilli Gjyqësor i Kosovës “KGJK”, Këshilli Prokurorial i Kosovës “KPK”, Akademia e Drejtësisë “AD”, etj.) dhe atyre që janë të angazhuar në procedurën e ndërmjetësit dhe marrin pjesë në të. Po ashtu, udhëzuesi ka për qëllim të ndikojë tek institucionet përkatëse që të avancojnë dhe sqarojnë më tej legjislacionin përkatës që ndërlidhet me ndërmjetësimin online në Republikën e Kosovës dhe funksionalizimin e zbatimit të nënshkrimit elektronik.

Udhëzuesi është përgatitur dhe publikohet në kuadër të projektit *“Drejt lehtësimit të qasjes në drejtësi në veri të Kosovës”* të implementuar nga Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (“ADRC”) të njohur si Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë (“MCM”)⁴ dhe të mbështetur nga National Endowment for Democracy (“NED”). Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që të lehtësoj qasjen në drejtësi me theks të veçantë të komuniteteve jo-shumicë (komuniteteve pakicë) dhe një integrim më të arrirë gjyqësor në Kosovë.

⁴ ADRC - MCM



I. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR NDËRMJETËSIMIN ONLINE

Ndërmjetësimi online

Përkufizimi i ndërmjetësimit online është i njëjtë me atë të ndërmjetësimit me prani fizike, me të vetmin ndryshim që në ndërmjetësimin online procedura zhvillohet përmes aplikimit të njohurive (dijeve) dhe pajisjeve të teknologjisë informative. Në ndërmjetësimin online të gjitha parimet, procedura dhe afatet janë të njëjta sikur me ndërmjetësimin me prani fizike. Ndërmjetësimi online mund të jetë i pjesshëm dhe i plotë.

Esenca, kuptimi dhe filozofia e ndërmjetësimit qëndron në faktin se kontestet apo mosmarrëveshjet në mes të njerëzve, janë gjithherë pjesë e pa ndarë e zhvillimit të jetës normale.⁵ Në Republikën e Kosovës, Ligji për Ndërmjetësim,⁶ ndërmjetësimin e përkufizon si një veprimtari jashtëgjyqësore, pra është metodë alternative për zgjidhjen e konflikteve⁷ ndërmjet subjekteve të së drejtës, e cila zhvillohet në mënyrë të pavarur nga sistemi gjyqësor. Kjo procedurë është tërësisht vullnetare si nga pikëpamja e përzgjedhjes së saj, si alternativë për zgjidhjen e konfliktit, në zgjedhjen e ndërmjetësuesit/es⁸ dhe deri në pranimin ose jo të marrëveshjes së propozuar. Ndërmjetësuesi/ja në krahasim me një gjyqtar/e nuk ka fuqi të imponojë një zgjidhje për kontestin apo mosmarrëveshjen e palëve.⁹ Ndërmjetësimi, pra është një procedurë me anë të të cilës palët kërkojnë të asistohen nga një apo disa ndërmjetësues/e, në përpjekjen për të arritur një zgjidhje miqësore të konfliktit që ka lindur mes tyre, e cila buron nga një marrëdhënie kontraktuale apo një marrëdhënie tjetër juridike.¹⁰

⁵ Hajrullah Mustafa: Ndërmjetësimi në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe efektshmeria pozitive e tij, *Opinio Juris*, Nr. 1/2015, f. 87


⁶ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 3 (1.1)

⁷ Konflikti mund të përkufizohet si situatë në të cilën individët nuk pajtohen apo kanë nevojë, interesa apo vlera të ndryshme të cilat rezultojnë në tensione në mes tyre. Shih Manual trajnimi: Ligji për ndërmjetësimin - USAID Prill 2012, f. 15. Më konkretisht “konflikti është fakti, ajo që ndodh dhe që nuk perceptohet njësoj nga të dyja palët.” - Shih Hajrullah Mustafa: Punim i cituar, f. 87

⁸ Ndërmjetësues/e është personi i tretë dhe neutral, i/e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i/e autorizuar për të ndërmjetësuar në mes të dy apo me shumë palëve që synojnë zgjidhjen e kontesteve, në përputhje me Ligjin për Ndërmjetësim, parimet, rregullat dhe procedurat e ndërmjetësimit. Shih Neni 22 Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim i cili përcakton kushtet për ndërmjetësuesit si dhe procesin e certifikimit dhe licencimit të tyre; Udhëzimin Administrativ (MD) Nr. 03/2019 për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës dhe Neni 3 (1.2), Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës

⁹ Shih dhe krahaso B. Biti, S. Fekolli, J. Çyrbja: Parimi i Konfidentalitetit në Proçesin e Ndërmjetësimit – Analize krahasuese Ndërmjet Ligjit Shqiptar, Ligjit Model UNCITRAL dhe Direktivës BE 200852EC, f. 48

¹⁰ Direktiva 2008/52/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 21 maj 2008 në Disa Aspekte të Ndërmjetësimit në Çështje Civile dhe Komerciale në Nenin 3 (a) jep përkufizimin si në vijim “Ndërmjetësimi nënkupton një proces të strukturuar, me anë të të cilit dy apo më shumë palë në një konflikt bëjnë përpjekje, mbi baza vullnetare, të arrijnë në një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit të tyre me ndihmën e një ndërmjetësuesi/e të referuar apo të emëruar prej tyre. Ky proces mund të jetë iniciuar nga palët ose sugjeruar ose urdhëruar nga gjykata ose parashikuar nga ligji i vendeve anëtare”; Shih po ashtu Ligji Model UNCITRAL (2002) “Për Ndërmjetësimin Ndërkombëtar Tregtar” 2002 dhe Udhëzuesi për Miratimin dhe Zbatimin e tij, 2002. UNCITRAL Model Law on International Commercial Mediation and International Settlement Agreements Resulting from Mediation, 2018



Procedura e ndërmjetësimit mund të iniciohet nga palët, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ. Si rrjedhojë kemi dy lloje të procedurave të ndërmjetësimit:

- › Procedurat e ndërmjetësimit me vetë-inicim të palëve - Procedurat e iniciuara nga vetë palët, të ashtuquajturat procedurat e ndërmjetësimit me vetë-inicim të palëve dhe
- › Procedurat e ndërmjetësimit të referuara - Procedurat e ndërmjetësimit të referuara nga organet kompetente (gjykatat, prokuroria dhe organet administrative).¹¹

Secila prej llojeve të mësipërme të procedurave të ndërmjetësimit mund të zhvillohet me pjesëmarrje fizike të palëve dhe ndërmjetësuesit/es të angazhuar apo edhe përmes teknologjisë, në mënyrë virtuale pa prani fizike, pra ndërmjetësimi online. Paragrafi 4 i Nenit 11 të Ligjit për Ndërmjetësim, hap mundësinë që procedurat e ndërmjetësimit të zhvillohen edhe përmes teknologjisë informative, duke përcaktuar si në vijim:


“Në procedurë të ndërmjetësimit, personi fizik duhet të jetë i pranishëm personalisht, përmes teknologjisë apo përfaqësimit me pëlqim të palëve, ndërsa personin juridik e përfaqëson personi i autorizuar.”

Ky paragraf është e vetmja pjesë e ligjit që i referohet ndërmjetësimit online. Mirëpo, duke u nisur nga fakti se të gjitha parimet, procedura dhe afatet janë të njëjta sikur me ndërmjetësimin me prani fizike, përkufizimi i ndërmjetësimit online mbetet i njëjtë me atë të ndërmjetësimit me prani fizike, me të vetmin ndryshim që procedura zhvillohet përmes aplikimit të njohurive (dijeve) dhe pajisjeve të teknologjisë informative (internetit, kompjuterëve dhe mjeteve të tjera të teknologjisë informative si tableta, iPad, Smart Boards, kamera digjitale dhe të ngjashme). Më tej, edhe formulimet në tri aktet nënligjore¹² që rregullojnë procedurën e ndërmjetësimit, që mund të iniciohen nga palët, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ, pothuajse përshkruajnë në formë të njëjtë paragrafin 4 të Nenit 11 të Ligjit për Ndërmjetësim.

Kështu, marrë parasysh Ligjin për Ndërmjetësimin dhe frymën dhe shkronjën e këtij ligji, për qëllime të këtij udhëzuesi termi "teknologji" përfshinë aplikimin e njohurive dhe pajisjeve të teknologjisë informative për zhvillimin online të procedurës së ndërmjetësimit. Korniza ligjore që e rregullon dhe trajton procedurën e ndërmjetësimit në Kosovë edhe pse nuk e ka elaboruar këtë pjesë më në gjerësi apo nuk i ka dhënë më shumë drejtim nenit përkatës të ligjit bazik përmes akteve nënligjore, ka ofruar mundësinë e përdorimit të teknologjisë apo zhvillimin e ndërmjetësimit online. Si rrjedhojë, ndërmjetësimi online mund të jetë i pjesshëm apo i plotë. Si procedurë e pjesshme e ndërmjetësimit mund të quhet ajo ku vetëm një pjesë e aktiviteteve si p.sh. komunikimi, seancat informuese, seancat

¹¹ Besim M. Kajtazi: Përmbledhje legjislacioni për ndërmjetësimin në Republikën e Kosovës, Shkrola, Prishtinë, Prill 2022, f. 10

¹² Shih Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ, Neni 5.2; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 9.3, dhe Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Neni 9.2



e ndërmjetësimit bëhen në mënyrë online, ndërsa pjesë tjera si nënshkrimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit dhe dokumenteve përkatëse bëhen me prani fizike. Në anën tjetër, procedurë e plotë e ndërmjetësimit mund të definohet ajo ku të gjitha aktivitetet dhe procedurat zhvillohen online, duke përfshirë dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të ndërmjetësimit.


Megjithatë, zbatimi i plotë i ndërmjetësimit online në praktikë ballafaqohet me disa kufizime që burojnë nga korniza e pamjaftueshme e akteve ligjore që do të mund bënin këtë të mundur dhe kjo vlen në veçanti për pjesën e marrëveshjeve të ndërmjetësimit. Në rrethanat aktuale (tetor 2022) ku ende nuk janë nxjerrë aktet përkatëse nënligjore që mundësojnë zbatimin praktik të nënshkrimit elektronik që do të duhej dhe është i nevojshëm, ndër të tjera, edhe për procedurën e ndërmjetësimit online dhe në mungesë të pajisjeve të personave me të drejtën e nënshkrimit elektronik, procedura e ndërmjetësimit online në praktikë mund të bëhet pjesërisht dhe vetëm nënshkrimi i marrëveshjes dhe dokumenteve përkatëse të bëhet me prani fizike, me dorë. Kjo pjesë do të elaborohet më në detaje më poshtë.

Debatet do të jenë të vazhdueshme lidhur me përdorimin e teknologjisë në procedurën e ndërmjetësimit, por një gjë është më se e sigurt që ndërmjetësimi offline dhe ndërmjetësimi online në parim janë të njëjta përveç që ndërmjetësimi online është proces edhe më pak formal, është më efektiv dhe efikas. Kjo edhe përkon me vetë konceptin e ndërmjetësimit e cili është procedurë më pak formale në të cilën palët e përfshira në konflikt përzgjedhin një ose më shumë ndërmjetësues/e për t'u ndihmuar në arritjen e një zgjidhje të kënaqshme për të dyja palët. Prandaj, është shumë e rëndësishme dhe e dobishme që ndërmjetësimi online, kur ka mundësi, të përdoret sa më shumë, gjithmonë në pajtim me atë që ofron legjislacioni në fuqi.

Përdorimi i teknologjisë në ndërmjetësimin online

Palët e përfshira në procedurën e ndërmjetësimit online duhet jo vetëm të njohin rëndësinë e përdorimit të teknologjisë por edhe duhet që ata/o të jenë të përgatitur që ta zbatojnë. Duke përqafuar dhe duke integruar teknologjinë në procedurën e ndërmjetësimit, mundësohet kursimi i kohës dhe punës dhe njëkohësisht është një përgatitje për të ardhmen e *"ekonomisë digjitale"*.

Teknologjia po bëhet gjithnjë e më tepër mbizotëruese dhe përdorimi i saj ka transformuar plotësisht mënyrën se si jetojmë. Prandaj është shumë e rëndësishme që edhe palët e përfshira në procedurën e ndërmjetësimit online jo vetëm të njohin rëndësinë e përdorimit të teknologjisë por edhe që ata/o të jenë të përgatitur që ta zbatojnë atë. Duke përqafuar dhe duke integruar teknologjinë në procedurën



e ndërmjetësimit, mundësohet kursimi i kohës dhe punës dhe njëkohësisht është një përgatitje për të ardhmen e “ekonomisë digjitale”.

Për secilën palë të përfshirë në ndërmjetësimin online duhet pasur parasysh që të:

- ✓ shfrytëzohen mjetet teknologjike dhe platformat përkatëse të përshtatshme që ju përshtaten palëve dhe ndërmjetësuesit/es dhe që janë lehtësisht të disponueshme për të lejuar përdoruesit të përdorin ato pa vështirësi;
- ✓ verifikohet se palët e përfshira dhe ndërmjetësuesi/ja a kanë të drejtën e nënshkrimit elektronik, që është i bazuar në certifikatë të kualifikuar dhe është krijuar me pajisje të sigurta (kur kjo të definohet);
- ✓ verifikohet, përpara se të vendoset një platformë e cila do të përdoret, se sa i përmbushë ajo platformë politikat e mbrojtjes së të dhënave dhe si sigurohet privatësia në ndërmjetësimin online dhe a lejohet që një gjë e tillë të përdoret brenda institucionit përkatës ku zhvillohet ndërmjetësimi;
- ✓ sigurohet ndërveprimi i platformave me mjetet dhe pajisjet ekzistuese digjitale;
- ✓ sigurohet një lidhje e fortë dhe e sigurt interneti si dhe gjendet një mjedis i qetë, ku nuk pengohet procedura e ndërmjetësimit online;
- ✓ testohen pajisjet e teknologjisë dhe platformat përpara se të fillohet seanca e ndërmjetësimit dhe kryhen prova të tyre para fillimit të seancave;
- ✓ bëhet komunikimi online me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme;
- ✓ sigurohet që ndërmjetësuesi/ja në fillim të procedurës të përfshijë informacione të përgjithshme në lidhje me procesin dhe efektet e ndërmjetësimit online;
- ✓ sigurohet që secila palë e përfshirë në procedurë të ruajë konfidencialitetin e procedurës së ndërmjetësimit online;
- ✓ ndihmohen pjesëmarrësit në ndërmjetësimin online që kanë më pak përvojë me teknologjinë për t'i njohur me mënyrën e veprimit të tyre.

Duhet cekur që në vitin 2020, KGJK me Vendim ka lejuar përdorimin e metodës online të procedurës së ndërmjetësimit në Gjykatat e Republikës së Kosovës, duke sugjeruar platformën Jitsi Meet.¹³ Këtë praktikë të KGJK-së duhet avancuar më tutje nga MD por edhe nga institucionet tjera, në mënyrë që të nxjerrin akte përkatëse, përmes të cilave mbështetet dhe sqarohet përdorimi i ndërmjetësimit online.

¹³ Shih Vendimin e KGJK Nr. 82/2020 (30.04.2020); https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/72699_Vendimi_KGJK_Nr._82_2020_Lejohet_perdorimi_metodes_online_ne_proceduren_ndermjetesimit.pdf www.jitsi.org Shih videon në linkun në vazhdim se si mund të qasen në një seancë online të ndërmjetësimit <https://www.gjyqesori-rks.org/2020/07/30/seancat-e-ndermjetesimit-edhe-ne-menyre-virtuale/>

Parimet e ndërmjetësimit online

Në procedurën e ndërmjetësimit online kanë efekt dhe duhet të zbatohen parimet e përcaktuara në Ligjin për Ndërmjetësim, si në vijim: Barazia e palëve; Shprehja e lirë e vullnetit të palëve; Paanshmëria dhe pavarësia; Privatësia dhe konfidencialiteti.

Procedura e ndërmjetësimit ka një numër të parimeve të rëndësishme, zbatimi i të cilave është thelbësor edhe për suksesin e procedurës së ndërmjetësimit online. Parimet, të përcaktuara në Ligjin për Ndërmjetësim, të cilat kanë efekt dhe zbatohen edhe në procedurën e ndërmjetësimit online janë: Barazia e palëve; Shprehja e lirë e vullnetit të palëve; Paanshmëria dhe pavarësia; Privatësia dhe konfidencialiteti. Duhet cekur që, sikurse në procedurën e ndërmjetësimit me prani fizike ashtu edhe në atë online, komunikimi i duhur është me rëndësi jetike. Prandaj, “Qëndrimet dhe shkathhtësitë e komunikimit të mirë, janë me rëndësi jetike për ata që dëshirojnë të veprojnë në mënyrë konstruktive përkitazi me konfliktin – qoftë si palë në konflikt apo si palë e tretë.”¹⁴

Për të shfrytëzuar plotësisht përfitimet e ndërmjetësimit online, është e rëndësishme që palët e përfshira t'i besojnë shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe të zbatojnë këto parime dhe dispozitat e legjisllacionit në fuqi për ndërmjetësimin. Këto parime janë garanci për palët që janë përfshirë apo që kërkojnë të futen në procedurën e ndërmjetësimit, prandaj shkelja/moszbatimi e/i këtyre parimeve gjatë ndërmjetësimit online cenon procedurën e ndërmjetësimit dhe si rrjedhojë edhe arritjen e zgjidhjes apo marrëveshjes.

Barazia e palëve në procedurën e ndërmjetësimit online

Në procedurën e ndërmjetësimit online palët janë të barabarta dhe kanë të drejta dhe detyrime në pajtim me ligjin.¹⁵ Ndërmjetësuesi/ja duhet të kujdeset që gjatë gjithë procedurës së ndërmjetësimit të ruhet barazia e palëve dhe të shmangen veprimet që shfaqin shenja të shkeljes së barazisë së palëve.

Shprehja e lirë e vullnetit të palëve


Procedura e ndërmjetësimit online zhvillohet me vullnetin e plotë dhe të lirë të palëve, të shprehur gojarisht dhe me shkrim.¹⁶ Palët në procedurë janë plotësisht të lira të vendosin për zhvillimin dhe të gjitha hapat e procedurës së ndërmjetësimit¹⁷ online. Po ashtu, palët nuk janë të obliguara të arrijnë

¹⁴ Doracak - Ndërmjetësimi në Kosovë - Proceset dhe shkathhtësitë, Partners-Kosova Center for Conflict Management, Laina Reynolds Levy, PhD, Partners for Democratic Change, Mars, 2011, f. 6

¹⁵ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 5

¹⁶ Shih Po aty, Neni 4 dhe Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës, Neni 4.1

¹⁷ Shih p.sh. Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 12.2



marrëveshje përmes ndërmjetësimit online, pa vullnetin e tyre të lirë.¹⁸ Ndërmjetësuesi/ja duhet të kujdeset gjatë gjithë procedurës së ndërmjetësimit online se palët me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë marrin pjesë dhe i japin drejtim secilës fazë të procedurës apo largimit nga procedura e ndërmjetësimit.¹⁹

Paanshmëria dhe pavarësia

Ndërmjetësuesi/ja gjatë zhvillimit të procedurës së ndërmjetësimit online duhet të mbetet plotësisht i/e pavarur dhe i/e paanshëm/me dhe duhet të ofrojë shërbimin e tij/saj, vetëm në ato çështje ku mund të mbetet i/e pavarur dhe i/e paanshëm, në të kundërtën duhet të refuzoj ndërmjetësimin, të njoftojë palët se nuk është në gjendje që të vazhdojë ndërmjetësimin dhe tërhiqet nga rasti përkatës. Njëkohësisht, ndërmjetësuesi/ja duhet të bëjë trajtimin e barabartë të të gjitha palëve në procedurë, duke shmangur çfarëdo lloj paragjykimi.²⁰

Privatësia dhe konfidencialiteti

Procedura e ndërmjetësimit online është e natyrës konfidenciale, seancat e ndërmjetësimit janë jo-publike dhe gjatë tyre nuk mbahet procesverbal dhe nuk duhet të incizohen. Ndërmjetësuesi/ja, palët dhe përfaqësuesit e tyre janë të obliguar që të ruajnë konfidencialitetin dhe çdo informacion të ditur në procedurën e ndërmjetësimit, përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.²¹ Duhet cekur që edhe pala e tretë që merr pjesë në procedurën e ndërmjetësimit është e detyruar të respektoj parimin e fshehtësisë së procedurës.²² Zbulimi i konfidencialitetit, përgjimet dhe incizimet pa autorizim janë rreptësisht të ndaluara dhe konsiderohen shkelje të rënda të detyrave të punës e njëkohësisht tërheqin edhe përgjegjësi penale sipas ligjit në fuqi.²³

Konflikti i interesit

Në kuadër të parimeve është e rëndësishme të përmendet dhe konflikti i interesit. Kështu, ndërmjetësuesi/ja duhet t'i shmangët konfliktit të interesit gjatë gjithë procedurës së ndërmjetësimit online.²⁴ Para fillimit të ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi/ja duhet t'i njoftoj palët për çfarëdo lloj konflikti të interesit që mund të haset e për të cilin ai/ajo ka arsye të besoj se ekziston. Ndërmjetësuesi/ja gjatë gjithë procedurës duhet të kujdeset në atë formë që nëse beson se pozita e tij/saj ose ndonjë rrethanë e njohur nga ai/ajo e vënë në pikëpyetje paanësinë e tij/saj, i/e njëjti/a duhet t'i deklaroj ato rrethana dhe të ndërmarrë veprime me anë të së cilave i shmangët konfliktit të

¹⁸ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 9.7

¹⁹ Shih Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 4.2; Shih B. Biti, S. Fekolli, J. Çyrbja: Punim i cituar, f. 49


²⁰ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 6 dhe Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 3 (1.3 dhe 1.4) dhe Neni 5

²¹ Shih Po aty, Neni 7; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 12 dhe Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Neni 12

²² Shih Po aty, Neni 12.8

²³ Shih Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 10

²⁴ Shih Po aty, Neni 3 (1.6) dhe Neni 6.1 dhe Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 18



interesit të mundshëm.²⁵ Nëse ndërmjetësuesi/ja tërhiqet, i njofton palët se mund të përzgjedhin një ndërmjetësues/e tjetër nga regjistri publik i ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës.²⁶

Pjesëmarrësit në procedurën e ndërmjetësimit online

Në procedurën e ndërmjetësimit online marrin pjesë dy apo më shumë palë të përfshira në kontest apo mosmarrëveshje dhe një apo më shumë ndërmjetësues/e. Përveç tyre, sipas rasteve kur autorizohen nga palët, marrin pjesë edhe përfaqësuesit/et e palëve si dhe mund të marrin pjesë edhe pala e tretë, pas pëlqimit paraprak të palëve në procedurë.

Në procedurën e ndërmjetësimit online marrin pjesë dy apo më shumë palë të përfshira në kontest apo mosmarrëveshje dhe një apo më shumë ndërmjetësues/e. Përveç tyre, sipas rasteve kur autorizohen nga palët, në procedurën e ndërmjetësimit online mund të marrin pjesë edhe përfaqësuesit/et e palëve. Personi fizik si palë e përfshirë në kontest apo mosmarrëveshje, mund të përfaqësohet nga personi i autorizuar, ndërsa personi juridik përfaqësohet nga përfaqësuesi/ja i/e autorizuar me autorizim të posaçëm me shkrim. Përfaqësuesit/et e palëve që marrin pjesë në ndërmjetësim, kanë autoritet të plotë për të arritur zgjidhje të kontestit apo mosmarrëveshjes, në qoftë se nuk është vendosur ndryshe nga të gjitha palët.²⁷ Po ashtu, duhet cekur që personi fizik si palë e përfshirë në kontest apo mosmarrëveshje, mund të ndihmohet nga ndonjë avokat/e.²⁸

Përveç palëve, përfaqësuesve të tyre dhe ndërmjetësuesit/es, në procedurën e ndërmjetësimit online mund të marrë pjesë edhe pala e tretë, pas pëlqimit paraprak të palëve në procedurë.²⁹ Po ashtu, rol në procedurën e ndërmjetësimit ka edhe referenti/ja për ndërmjetësim, gjegjësisht, zyrtari/ja i/e gjykatës që administrojnë me lëndët e referuara për ndërmjetësim nga gjykata dhe organet administrative, si dhe zyrtari/ja i/e prokurorisë që administron me rastet e referuara nga prokuroria. Zyrtarët për ndërmjetësim si më lartë mund t'i asistojnë palët edhe me rastet e ndërmjetësimit me vetë-inicim.³⁰

²⁵ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 18.1


²⁶ Shih Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës, Neni 6.3; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 10, dhe Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Neni 10

²⁷ Shih Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ, Neni 5 (2 dhe 3), dhe Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 9.2

²⁸ Shih Po aty, Neni 5.2

²⁹ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 12.7

³⁰ Shih Po aty, Neni 3 (1.3)



Të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedurën e ndërmjetësimit online

Të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedurën e ndërmjetësimit online janë të njëjta me ato të përcaktuara për ndërmjetësimin me prani fizike, që përfshijnë por nuk kufizohen në të drejtën e palëve për të vendosur në lidhje me procedurën e ndërmjetësimit; të drejtën e ndërmjetësuesit/es dhe të palëve për të përfunduar ose ndërprerë ndërmjetësimin online; ruajtjen e fshehtësisë të komunikimeve dhe dokumenteve; pagesën e tarifës së ndërmjetësuesit/es dhe mënyrën e pagesës.

Në procedurën e ndërmjetësimit online, të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësuesit/es dhe palëve duhet të specifikohen para fillimit të procedurës, si rrjedhojë palët e përfshira duhet t'u përmbahen këtyre deri në përfundim të procedurës dhe pas saj.³¹

Ndërmjetësuesi/ja para fillimit të procedurës së ndërmjetësimit online duhet të njoftojë palët rreth ndërmjetësimit online dhe rolit të tyre përfshirë të drejtën e tyre për të marrë vendime në procedurë duke respektuar detyrën dhe rolin e ndërmjetësuesit/es.³² Në këtë drejtim, para fillimit të ndërmjetësimit online, ndërmjetësuesi/ja sigurohet se palët hyjnë në procedurë të ndërmjetësimit me vullnet të lirë dhe ato e kuptojnë mjaftueshëm procedurën dhe parimet e ndërmjetësimit online, duke përfshirë por mos u kufizuar në:

- › Të drejtën e palëve për të vendosur në lidhje me procedurën e ndërmjetësimit;
- › Të drejtën e ndërmjetësuesit/es dhe të palëve për të përfunduar ose ndërprerë ndërmjetësimin online;
- › Ruajtjen e fshehtësisë të komunikimeve dhe dokumenteve;
- › Pagesën e tarifës së ndërmjetësuesit/es dhe mënyrën e pagesës.³³


Në procedurën e ndërmjetësimit online, roli kryesor i ndërmjetësuesit/es është që të lehtësojë zgjidhjen vullnetare të kontestit apo mosmarrëveshjes dhe duhet t'u ofrojë mundësinë palëve që të hulumtojnë të gjitha mundësitë për zgjidhjen e saj. Ndërmjetësuesi/ja mund të propozoj mundësi për zgjidhjen e kontestit apo mosmarrëveshjes, por jo edhe vetë zgjidhjen.³⁴ Për të pasur sukses ndërmjetësimi online është shumë e rëndësishme që ndërmjetësuesit e licencuar, të plotësojnë edhe kërkesat e mëposhtme:

³¹ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 24

³² Shih Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 7.4


³³ Shih Po aty, Neni 13.1

³⁴ Shih Po aty, Neni 7.1



- ✓ të jenë në gjendje të ofrojnë shërbimet e tyre të ndërmjetësimit online dhe të bëjnë përgatitjen e formave përkatëse për marrëveshjen me shkrim për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit dhe dokumenteve tjera të nevojshme;
- ✓ të jenë të pranishëm para kohës në seancën të ndërmjetësimit online dhe të qëndrojnë të gatshëm me anë të mesazhit elektronik dhe telefonit, në rast se palët dhe pjesëmarrësit kanë probleme për t'u kyçur në seanca të ndërmjetësimit online;
- ✓ që gjatë gjithë kohës të përkujdesen që shërbimet e tyre të ndërmjetësimit online t'i zhvillojnë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe të përkujdesen që edhe palët e përfshira të bëjnë një gjë të tillë;
- ✓ të marrin rol aktiv, në sugjerimin e palëve për atë që ai/ajo beson se është e drejtë, në mënyrë që t'i ndihmojë ata/o të shmangin ndonjë pengesë në zgjidhjen e kontestit apo mosmarrëveshjes së tyre;³⁵
- ✓ të ofrojnë udhëzime për të ndihmuar palët e përfshira në procedurën e ndërmjetësimit online në zbatimin e parimeve dhe kushteve të ndërmjetësimit të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi dhe këto informacione të jenë të qarta për të shmangur pyetjet që marrin shumë kohë apo keqkuptime online, si dhe informacionet të prezantohen në fillim të procedurës në kohën dhe në formatin e duhur;
- ✓ të bëjnë të qartë mënyrën e sjelljes online për të krijuar një hapësirë të sigurt për palët;
- ✓ të kontribuojnë në mënyrë efektive në përpjekjen për të zhvilluar seancat e ndërmjetësimit online duke krijuar një atmosferë pozitive për të krijuar besim tek palët;
- ✓ të bëhet planifikimi i seancave të ndërmjetësimit dhe të tentohet që këto të mos zgjasin shumë (preferohet jo me shumë se katër orë në ditë);
- ✓ të planifikohen pushime, apo kohë individuale për reflektim të palëve si dhe të përkujdesen që të mos ketë heshtje të gjata gjatë seancave të ndërmjetësimit online dhe të shikojnë me kujdes për të "thyer akullin" në rastet e tilla, gjithnjë duke marrë parasysh që heshtjet e gjata mund të jenë të paretshme gjatë ndërmjetësimit online;
- ✓ të përkujdesen paraprakisht që të kenë informata sa njohuri dhe çfarë përvojë të mëparshme kanë palët në ndërmjetësimin online dhe cilat janë njohurit e tyre në përdorimin e mjeteve të teknologjisë;
- ✓ sipas nevojës të kryhen edhe prova teknike fakultative për palët që janë pa përvojë dhe t'u sqarohen pyetjet drejtpërdrejtë apo të zgjidhen vështirësitë teknike;
- ✓ të përkujdeset që secilës palë t'i jepet mundësia të shprehë mendimet, apo komentet e veta;
- ✓ në rastin e bashkë-ndërmjetësimit, ndërmjetësuesit paraprakisht t'i përcaktojnë rolet dhe të koordinohen së bashku.

³⁵ Shih Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 7



Siç është përcaktuar në Kodin e Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, ndërhyrjet në procedurë, udhëzimi i palëve në vendimmarrje, nxitja e konfliktit mes palëve, dhe sjellje të vrazhda të cilat ndërmjetësuksi/ja mund t'i bëjë gjatë ushtrimit të profesionit të ndërmjetësuesit/es, janë sjellje joprofesionale,³⁶ prandaj në ndërmjetësimin online, ndërmjetësuksi/ja duhet të mos ketë sjellje joprofesionale. Duhet pasur parasysh që shkelje disiplinore të ndërmjetësuesve, edhe në ndërmjetësimin online, ndër të tjera konsiderohen kryerja e kundërligjshme apo e pandërgjegjshme të detyrës zyrtare si ndërmjetësues/e, në kundërshtim me Ligjin për Ndërmjetësim, Kodin e Mirësjelljes të Ndërmjetësuesve, dhe legjislacionin përkatës. Ndaj ndërmjetësuesve që kanë kryer shkelje shqiptohen masat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.³⁷

Kohëzgjatja dhe shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimin online

Në ndërmjetësimin online vlejné të gjitha afatet dhe kostot e shpenzimeve, sikurse për ndërmjetësimin me prani fizike.

Edhe në ndërmjetësimin online vlejné të gjitha afatet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Palët duhet të arrijné marrëveshje brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për hyrje apo fillim të procedurës së ndërmjetësimin. Nëse palët nuk mund të arrijné marrëveshje për zgjedhjen e ndërmjetësuar brenda nëntëdhjetë (90) ditëve, atëherë ato përmes ndërmjetësuesit/es mund t'i drejtohen organit kompetent që ka aprovuar referimin e rastit të tyre në ndërmjetësim për të zgjatur afatin për edhe tridhjetë (30) ditë të tjera. Ndërsa kur palët në rastet me vetë-inicim nuk kanë arritur të zgjidhin kontestin apo mosmarrëveshjen brenda afatit nëntëdhjetë (90) ditë, ato bashkërisht me ndërmjetësuesin/en mund të nënshkruajnë marrëveshje për një afat shtesë prej tridhjetë (30) ditësh. Në të gjitha rastet edhe tek ndërmjetësimi online duhet pasur kujdes që vazhdimi i afatit nuk sjellë pasoja ligjore në humbjen e së drejtës ose fitimin e të drejtave për një palë me kalimin e kohës.³⁸ Procedura e ndërmjetësimin online përfundon me kalimin e afatit ligjor për arritjen e marrëveshjes.³⁹

Ndërmjetësuksi/ja, për zhvillimin e ndërmjetësimin online ka të drejtë në kompensim monetar si kundërvlerë e shërbimit të ndërmjetësimin dhe kostoja e shpenzimeve të procedurës së

³⁶ Shih Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 3 (1.5) dhe Neni 9

³⁷ Shih Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 04/2019 për Mbikëqyrjen, Përgjegjësinë dhe Procedurën Disiplinore të Ndërmjetësuesve, Neni 4 dhe 5

³⁸ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 16

³⁹ Shih Po aty, Neni 17.1 (1.4)



ndërmjetësimi online është e njëjtë me tarifën e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (MD) Nr. 4/2021 për Tarifën e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës.⁴⁰

Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimi online paguhen proporcionalisht nga palët, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe.⁴¹ Ndërmjetësuesi/ja është i obliguar që palës t'i lëshoj faturën për tarifën dhe shpenzimet e paguara, që përmban të dhënat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MD) Nr. 4/2021 dhe një nga të dhënat që kërkohet është edhe nënshkrimi i faturës.⁴² Në nënshkrimin e faturës për tarifën dhe shpenzimet e paguara në procedurën e ndërmjetësimi online, zbatohen përshtatshmerisht rregullat e nënshkrimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimi online.

Nënshkrimi i marrëveshjeve në procedurën e ndërmjetësimi online

Nënshkrimi i marrëveshjeve në procedurën e ndërmjetësimi online, qoftë me dorë apo me nënshkrim elektronik (që është i bazuar në certifikatë të kualifikuar të lëshuar nga ofruesi i akredituar i shërbimeve të certifikimit dhe i krijuar me pajisje të sigurta për krijimin e nënshkrimit), është një nga kriteret që marrëveshjet në procedurën e ndërmjetësimi të jenë valide.

Marrëveshja për hyrje në ndërmjetësim apo për fillimin e procedurës së ndërmjetësimi dhe marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar (e ndërmjetësimi) janë dy marrëveshjet kryesore me shkrim në procedurën e ndërmjetësimi, që duhet nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi/ja që marrin pjesë në të. Përderisa përmes marrëveshjes së parë jepet pëlqimi për fillimin e procedurës së ndërmjetësimi⁴³ online, marrëveshja e ndërmjetësimi është marrëveshje e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi/ja për zgjidhjen e kontestit apo mosmarrëveshjes ndërmjet palëve në procedurën e ndërmjetësimi⁴⁴ online. Edhe marrëveshja e ndërmjetësimi online ka fuqinë e titullit ekzekutiv - përmbaues dhe është e detyrueshme vetëm për palët që janë në kontest apo mosmarrëveshje dhe vetëm për objektin e marrëveshjes.⁴⁵ Pra, edhe marrëveshja e ndërmjetësimi online duhet të jetë në pajtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe e përshtatshme për përmbaues.⁴⁶ Duke ju referuar Nenit 57 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për marrëveshjet në procedurën e ndërmjetësimi nevojitet përpilimi i dokumentit, dhe se marrëveshja është e arritur kur

⁴⁰ Shih Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 4/2021 për Tarifën e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës, Neni 6 dhe Tabela 1: Tarifa për rast për rastet me vetë-inicim

⁴¹ Shih Po aty, Neni 19.1


⁴² Shih Po aty, Neni 8 (5.1)

⁴³ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 11.2

⁴⁴ Shih Po aty, Neni 3 (1.6)

⁴⁵ Po aty, Neni 3 (1.6) dhe Neni 14 (4 dhe 5)

⁴⁶ Po aty, Neni 14 (4 dhe 5)



dokumentin e nënshkruajnë palët dhe ndërmjetësuesi/ja. Në rastet kur njëra nga palët, në marrëveshjen e ndërmjetësimit nuk di të shkruajë, do të vejë në dokument shenjën e gishtit të vërtetuar nga dy dëshmitarë ose nga gjykata apo organi tjetër.⁴⁷ Por, duke ju referuar po të njëjtës dispozitë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Neni 57 (4 dhe 5)):

“Kërkesa e formës me shkrim është e përmbushur, në qoftë se palët këmbëjnë letra ose merren vesh me ndonjë mjet tjetër që bënë të mundur që me siguri të përcaktohet përmbajtja dhe personi, i cili e ka dhënë deklaratën. Në qoftë se me ligj shprehimisht nuk caktohet ndryshe, forma me shkrim zëvendësohet edhe me deklarata me mjete elektronike, për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të veçantë.”

Pra, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve po ashtu lejon përdorimin e teknologjisë/mjeteve elektronike në procedurën e ndërmjetësimit dhe në nënshkrimin e marrëveshjeve të ndërmjetësimit, gjithnjë duke marrë parasysh që në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.


Nënshkrimi i marrëveshjeve në procedurën e ndërmjetësimit, qoftë me dorë apo me nënshkrim elektronik, është një nga kriteret që këto të jenë valide. Gjykata ose prokuroria mund të anuloj marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur konstaton se është lidhur në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe kur nuk pasqyrohet vullneti i palëve në ndërmjetësim.⁴⁸ Prandaj edhe në këtë drejtim është e nevojshme që gjykatat dhe prokuroritë, sipas shembullit të vendimit të KGJK-së që ka udhëzuar drejt një platforme të përdorimit për ndërmjetësimin online në Gjykatat e Republikës së Kosovës, të nxjerrin akte përkatëse normative me të cilat përcaktojnë mënyrën e përdorimit të nënshkrimit elektronik tek marrëveshjet e ndërmjetësimit, në mënyrë që të mos vije në situatë të tillë që pas përfundimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit të mos pranohen nga gjykatat dhe prokuroritë por edhe nga organet përkatëse administrative.

Gjersa nënshkrimi i dorës është i qartë dhe nënkupton që këto marrëveshje duhet të nënshkruhen nga palët dhe ndërmjetësuesi/a, problem në vete paraqet çështja e nënshkrimit “përmes teknologjisë” apo nënshkrimi elektronik, i marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, marrëveshjes së ndërmjetësimit si dhe të dokumenteve tjera përkatëse që mund të përdoren në këtë procedurë. Sipas përkufizimit që jep legjislacioni në fuqi, nënshkrimi elektronik përfshinë të dhënat në formë elektronike, të cilat u bashkëngjiten ose shoqërojnë logjikisht porosinë e të dhënave, dhe që mund të përdoren për të identifikuar nënshkruesin në lidhje me porosinë e të dhënave.⁴⁹ Derisa çdo shtetas/e i/e Republikës së Kosovës nga moshë gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare, është i/e detyruar të pajiset me

⁴⁷ Shih Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Neni 57

⁴⁸ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 17.5

⁴⁹ Shih Ligji Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim, Neni 2 (1.9)



letërnjoftim,⁵⁰ ky letërnjoftim i ka hapur mundësinë çdo shtetasi/e për kryerjen e shërbimeve elektronike.⁵¹ Për kryerjen e këtyre shërbimeve elektronike, nënshkrimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit duhet të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike dhe me Ligjin Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike.

Sipas Nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike, nëse në ndonjë ligj në Kosovë kërkohet nënshkrimi i personit gjegjësisht nëse kërkesa për nënshkrim është në formë të një obligimi ose nëse ligji paraqet pasojat për mungesën e nënshkrimit, kërkesa e tillë konsiderohet e plotësuar nëse nënshkrimi i tillë është në formën e nënshkrimit elektronik të avancuar, që është i bazuar në certifikatë të kualifikuar dhe është krijuar me pajisje të sigurta për krijimin e nënshkrimit, dhe nënshkrimi i tillë do të konsiderohet si nënshkrim i nënshkruesit për të gjitha synimet dhe qëllimet e ligjit.⁵² Pra, nënshkrimi elektronik është i vlefshëm dhe i pranueshëm dhe nuk i mohohet vlefshmëria ose pesha e provës vetëm se është në formë elektronike dhe ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi i dorës.⁵³ Duhet pasur kujdes që nënshkrimi elektronik konsiderohet i pavlefshëm, kur vërtetohet se nuk i ka përmbushur kërkesat e sigurisë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.⁵⁴

Derisa Ligji për Ndërmjetësim kërkon shprehimisht që marrëveshja për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit dhe marrëveshja e ndërmjetësimit duhet nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi/ja, atëherë për të pasur efekt juridik marrëveshja, duhet të jetë e nënshkruar me dorë apo me nënshkrim elektronik që është i bazuar në certifikatë të kualifikuar të lëshuar nga ofruesi i akredituar i shërbimeve të certifikimit dhe i krijuar me pajisje të sigurta për krijimin e nënshkrimit.

Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike, përcakton dokumentacionin në formë elektronike juridikisht të barabartë me dokumentacionin tradicional të paraqitur në format të letrës, për të lehtësuar shërbimet elektronike që përfshijnë, por që nuk kufizohen në aplikimin e nënshkrimit elektronik.⁵⁵ Ky ligj bënë vlefshmërinë e kontratave elektronike, gjegjësisht në rastin e procedurës së ndërmjetësimit bëhet vlefshmëria e marrëveshjeve elektronike të ndërmjetësimit. Sipas Nenit 11, kontratës elektronike nuk do t'i mohohet efekti ligjor, vlefshmëria ose detyrueshmëria vetëm në bazë të asaj se ajo është plotësisht ose pjesërisht në formë elektronike ose ka filluar plotësisht ose pjesërisht me mënyrën elektronike të komunikimit. Për qëllime të çdo ligji në lidhje me kontratat, një ofertë, pranimi i ofertës dhe çdo komunikim relevant, duke përfshirë çdo amendamentim pasues,

⁵⁰ Shih Ligji Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim, Neni 3.1


⁵¹ Shih Po aty, Neni 4.5

⁵² Shih Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-022, Neni 6

⁵³ Shih, Ligji Nr. 08/L-022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike, Neni 32

⁵⁴ Shih Po aty, Neni 34.2

⁵⁵ Shih Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike, Neni 1.1



anulim ose revokim të ofertës, pranimi i kontratës mund, veç nëse ndryshe janë dakorduar nga palët kontraktuese, të komunikohet nëpërmjet komunikimit elektronik.⁵⁶

Ndërsa Ligji Nr. 08/L - 022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike, rregullon kushtet e përdorimit të nënshkrimit elektronik, vulës elektronike, vulës elektronike kohore dhe të pajisjeve për krijimin e tyre, shërbimet e regjistruara elektronike për procedurat gjyqësore dhe procedurat tjera, kushtet e lëshimit dhe përdorimit të certifikatave të kualifikuara për certifikimin e shërbimeve dhe autentifikimin e faqes së internetit, shërbimet e besuara në transaksionet elektronike dhe dokumentet elektronike.⁵⁷

Siç shihet më sipër, ligjet që rregullojnë nënshkrimet dhe vulat elektronike kanë hapur mundësinë që të bëhet nënshkrimi elektronik edhe i marrëveshjeve të ndërmjetësimit, megjithatë akoma nuk gjejnë zbatimin të tyre pa nxjerrjen e akteve nënligjore dhe krijimin e organeve përkatëse që duhet të akreditohen për ofrimin e shërbimeve të certifikimit dhe për të lëshuar certifikatë të kualifikuar. Me këto akte nënligjore, duhet të përcaktohen kushtet dhe kriteret të cilat duhet të plotësoj një pajisje për krijimin e nënshkrimeve dhe/ose vulave elektronike të kualifikuara, si dhe kushtet që duhet të plotësojë organi i caktuar për vlerësimin e konformitetit pajisjeve të kualifikuara për krijimin e nënshkrimit dhe/ose vulës elektronik të kualifikuar.⁵⁸ Deri në nxjerrjen e këtyre akteve dhe krijimin e organeve përkatëse që mundësojnë që të jetë i vlefshëm dhe i pranueshëm, nënshkrimi elektronik i marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit dhe marrëveshjes së ndërmjetësimit si dhe dokumenteve tjera përkatëse që mund të ketë, duhet të bëhet në formë fizike, me nënshkrim të dorës. Kur të krijohen kushtet e tilla prej të cilave nuk mund të mohohet vlefshmëria e nënshkrimit elektronik atëherë nënshkrimi i marrëveshjeve bëhet edhe në formë elektronike, nënshkrimi elektronik.

⁵⁶ Shih Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike, Neni 11, dhe në Nenin 2 (1.8) ku jepet përkufizimi i komunikimit i cili përfshin "çdo shkëmbim ose bartje informacioni ndërmjet numrave të caktuar të palëve nëpërmjet shërbimeve publike elektronike në dispozicion. Kjo nuk përfshin ndonjë informatë të bartur si pjesë e një shërbimi transmetues për publikun nëpërmjet një rrjeti të komunikimit elektronik përveç nëse informacioni ka të bëjë me palën, si klient, abonent, regjistruar të identifikueshëm ose shfrytëzuesin që merr informacionin."

⁵⁷ Shih Ligji Nr. 08/L - 022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike, Neni 1

⁵⁸ Në këtë fushë është tepër e rëndësishme që të transpozohet Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2015/1506, i datës 8 shtator 2015, që përcakton specifikimet në lidhje me formatet e nënshkrimeve elektronike të avancuara dhe vulate të avancuara që do të njihen nga organet e sektorit publik në përputhje me nenet 27.5 dhe 37.5 të Rregullores (BE) Nr. 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besimit për Transaksionet Elektronike në Tregun e Brendshëm.

Aftësimi profesional dhe promovimi i ndërmjetësimit online

Institucionet përgjegjëse në fushën e ndërmjetësimit si dhe partnerët zhvillimor duhet të organizojnë trajnime për ndërmjetësimin online, për t'u pasuruar ndërmjetësuesit/et me njohuri të reja për ushtrimin e ndërmjetësimit online.

MD duhet të hartojë akte përkatëse nënligjore që sqarojnë më në detaje çështjen e zhvillimit të procedurës online si dhe të promovojë ndërmjetësimin online.

MD, AD dhe ONDK kanë përgjegjësitë kryesore edhe për aftësimin profesional për mbajtjen dhe zhvillimin e procedurave të ndërmjetësimit online.

MD, përmes njësive përkatëse (Departamenti për Profesione të Lira dhe Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira) dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse është përgjegjëse për propozimin, hartimin dhe sigurimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e ndërmjetësimit,⁵⁹ si dhe programet e trajnimeve në fushën e ndërmjetësimit. Në rrjedhë të kësaj përgjegjësie, MD duhet të hartojë aktet përkatëse nënligjore që sqaron më në detaje çështjen e zhvillimit të procedurës online. Ajo po ashtu ka përgjegjësi dhe duhet të angazhohet në organizimin e kampanjave të ndryshme me qëllim të informimit të publikut për mundësitë e shfrytëzimit të ndërmjetësimit online, si dhe në promovimin e kësaj procedure.⁶⁰ Është e rëndësishme që edhe në fushën e ndërmjetësimit online të organizohen trajnime për ndërmjetësimin online, për t'u pasuruar ndërmjetësuesit me njohuri të reja për ushtrimin e ndërmjetësimit.⁶¹ Në këtë drejtim edhe AD duhet të organizojë, zhvillojë dhe realizojë, trajnime të vazhdueshme profesionale për ndërmjetësues, në bazë të vlerësimeve të saj, apo në bashkëpunim me, apo, sipas kërkesave të institucioneve përkatëse⁶² dhe akterëve tjerë kontribues të ndërmjetësimit në vend. Po ashtu, edhe ONDK ka përgjegjësi në ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimeve të vazhdueshme nga fusha të ndryshme në profesionin e ndërmjetësuesve.⁶³ Njëkohësisht edhe një nga qëllimet e ONDK-së, duhet të jetë promovimi dhe ngritja e vetëdijesimit mbi përdorimin e ndërmjetësimit online, si dhe organizimi i fushatave dhe


⁵⁹ Shih Rregullorja (QRK) Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë (13.11.2013) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 12/2018 (31.07.2018), Neni 17, Neni 19 dhe Neni 24/A

⁶⁰ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 20.3, dhe Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 06/2019 për Trajnimin dhe Certifikimin e Ndërmjetësuesve, Neni 20

⁶¹ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 20.2, dhe Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 06/2019 për Trajnimin dhe Certifikimin e Ndërmjetësuesve, Neni 20

⁶² Shih Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, Neni 6

⁶³ Statuti (MD) Nr. 06/2020 i Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës, Neni 6 (1.3); Shih Rregulloren (MD) Nr. 05/2020 për Punën e Kuvendit të Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës



aktiviteteve të ndryshme për këtë qëllim.⁶⁴ Në të gjitha këto aktivitete, institucionet dhe organet e përmendura më lartë mund dhe duhet të mbështeten edhe nga partner zhvillimor dhe akterë kontribues të sistemit të ndërmjetësimit në vend.

Edhe ndërmjetësuesit mund të promovojnë shërbimet e tyre të ndërmjetësimit online dhe ky promovim duhet të jetë në mënyrë profesionale, të besueshme dhe me dinjitet. Duhet pasur parasysh që gjatë promovimit të ndërmjetësimit online, ndërmjetësuesi/ja nuk u garanton palëve potenciale zgjidhjen e kontestit apo mosmarrëveshjeve e as nuk premtion rezultate të caktuara nga ndërmjetësimi,⁶⁵ përfshirë dhe ndërmjetësimi online.

II. HAPAT NË PROCEDURËN E NDËRMJETËSIMIT ONLINE

Pajtimi i palëve për zhvillimin e ndërmjetësimit online

Palët e përfshira në kontest, me vullnetin e lirë të tyre (i shprehur gojarisht dhe me shkrim), pajtohen për zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit online dhe përzgjedhin një ose më shumë ndërmjetësues/e për t'u ndihmuar në arritjen e një zgjidhje të kënaqshme për ata/o, gjegjësisht në lidhjen e marrëveshjes në procedurën e ndërmjetësimit.

Palët hyjnë në procedurën e ndërmjetësimit online dhe e zhvillojnë atë në bazë të vullnetit të tyre të plotë të lirë. Si hap i parë, ata/o duhet të pajtohen që të zgjidhin kontestin apo mosmarrëveshjen e tyre përmes ndërmjetësimit online. Në këtë rast ata/o pajtohen edhe për mënyrën dhe formën e zhvillimit të ndërmjetësimit online.⁶⁶ Para se të fillojë procedura e ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi/ja është i/e obliguar t'i informojë palët për parimet, rregullat, shpenzimet e procedurës dhe efektet juridike të marrëveshjes.⁶⁷ Tek rastet e referuara nga gjykata dhe nga prokuroria, kur seancat e ndërmjetësimit mbahen online, paraprakisht duhet të njoftohet zyrtari/ja për ndërmjetësim. Në këto raste, ndërmjetësuesi/ja merr vetëm kopjet e shkresave të lëndës.⁶⁸


⁶⁴ Statuti (MD) Nr. 06/2020 i Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës, Neni 6 (1.4)

⁶⁵ Shih dhe krahaso Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 11

⁶⁶ Shih dhe krahaso Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 12

⁶⁷ Shih dhe krahaso Po aty, Neni 11.1

⁶⁸ Shih Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 9.4; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Neni 9.3, si dhe Protokollin për Referimin e Rasteve në Ndërmjetësim, (KGJK, 01.03.2022)



Nënshkrimi i marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit online

Palët e përfshira në kontest apo mosmarrëveshje, me vullnetin e tyre të lirë, lidhin Marrëveshje për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, nëpërmjet të cilës jepet pëlqimi për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit online dhe mënyrën e zhvillimit të procedurës online.

Hap shumë i rëndësishëm, nga i cili varet fillimi apo mos fillimi i procedurës së ndërmjetësimit online, pas të cilit fillojnë të rrjedhin edhe afatet, është pëlqimi për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit gjegjësisht nënshkrimi i marrëveshjes për hyrje në procedurën e ndërmjetësimit online. Procedura e ndërmjetësimit online fillon zyrtarisht në ditën kur palët nënshkruajnë marrëveshjen për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit e cila duhet të përmbajë të dhënat si në vijim: palët në procedurë dhe përfaqësuesit e tyre; objektin e ndërmjetësimit; deklaratën e pranimit të ndërmjetësimit si dhe shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit dhe tarifën e ndërmjetësuesit/es. Marrëveshja për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, varësisht nga kush është referuar nënshkruhet duke përdorur format e shtojcave përkatëse të akteve përkatëse nënligjore.⁶⁹ Në rastet e referuara, pas nënshkrimit të marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, zyrtari/ja për ndërmjetësim e informon organin iniciues, duke i'a dorëzuar një kopje të marrëveshjes së nënshkruar për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, me që rast organi iniciues do të pezullojë procedurën, deri sa të kalojë afati i ndërmjetësimit.⁷⁰ Pas nënshkrimit të marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi/ja në pajtim me palët, do të caktoj kohën dhe mënyrën e zhvillimit të seancave të ndërmjetësimit⁷¹ online.


Seancat e ndërmjetësimit online

Seancat e ndërmjetësimit online janë takimet e ndërmjetësuesit/es me palët, me qëllim të zgjidhjes së kontesteve apo mosmarrëveshjeve. Seancat e ndërmjetësimit online janë jo-publike dhe gjatë mbajtjes së tyre nuk mbahet procesverbal dhe nuk duhet të incizohen.

⁶⁹ Shih dhe krahaso Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 11.3; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 9.1, dhe Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Neni 9.1, Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ, Neni 8.2

⁷⁰ Shih Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 4/2021 për Tarifën e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës, Neni 8.1

⁷¹ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 12.5



Pas nënshkrimit të marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit online, palët janë të lira të vendosin për zhvillimin saj online dhe mbajtjen e seancave të ndërmjetësimit online. Seanca të ndërmjetësimit online janë takimet e ndërmjetësuesit/es me palët, me qëllim të zgjidhjes së kontesteve apo mosmarrëveshjeve, në pajtim me parimet e ndërmjetësimit.⁷² Ndërmjetësuesi/a në pajtim me palët, caktojnë kohën dhe mënyrën e zhvillimit të seancave online. Palët janë të obliguara që gjatë procedurës, të prezantojnë në mënyrë sa më reale dhe të vërtetë rrethanat e rastit kontestues.⁷³

Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar në ndërmjetësimin online

Marrëveshja për zgjedhjen e ndërmjetësuar varet ekskluzivisht nga vullneti i palëve. Ndërmjetësuesi/ja duhet të ndihmoj palët dhe të jetë i/e përkushtuar për arritjen e marrëveshjes së ndërmjetësimit online. Pasi që palët të kenë arritur marrëveshjen, ndërmjetësuesi/ja përpilon me shkrim marrëveshjen e ndërmjetësimit, të cilën duhet ta nënshkruajnë palët dhe ndërmjetësuesi/ja (qoftë me nënshkrim të dorës apo nënshkrim elektronik).


Marrëveshja për zgjedhjen e ndërmjetësuar “është ajo marrëveshje e cila përmban në vete të gjitha çështjet për të cilat palët në kontest kanë arritur të merren vesh”⁷⁴ dhe varet ekskluzivisht nga vullneti i palëve. Pasi që palët të kenë arritur marrëveshjen, ndërmjetësuesi/ja përpilon me shkrim marrëveshjen, e cila më pas duhet të nënshkruhet nga palët dhe ndërmjetësuesi/ja. Marrëveshja duhet të jetë e qartë dhe duhet të përfshijë të gjitha pikat për të cilat palët janë marrë vesh. Ndërmjetësuesi/ja është i/e obliguar që pas përpilimit me shkrim të marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar dhe para se palët apo përfaqësuesit e tyre ta nënshkruajnë atë, të sigurohet se e ka pasqyruar saktë dhe drejtë vullnetin e palëve në marrëveshje dhe të njëjtën e lexon me zë për ta konfirmuar se palët nuk kanë vërejtje në tekstin e hartuar. Më pas, ndërmjetësuesi/ja ju kërkon palëve të japin komente para se të iniciohet procesi i nënshkrimit, dhe vetëm pasi palët të pajtohen me përmbajtjen e marrëveshjes atëherë finalizohet marrëveshja dhe nënshkruhet nga palët dhe nga ndërmjetësuesi/ja.⁷⁵

⁷² Shih dhe krahaso, Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 04 /2021 për Tarifën e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës, Neni 3 (1.3)

⁷³ Shih dhe krahaso, Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 12

⁷⁴ Shih Udhëzues me Modelet e Marrëveshjes së Ndërmjetësimit, USAID, Prill 2021, f. 5.

⁷⁵ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 3 (1.6) dhe Neni 14; Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ, Neni 10; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave; Neni 13; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Neni 13



Ndërmjetësuesi/ja nuk e ruan marrëveshjen e shkruar të arritur në ndërmjetësim në mes palëve. Palët pajisen me marrëveshjen për zgjidhjen e ndërmjetësuar dhe në rast të humbjes apo shkatërrimit të saj mund të kërkon nga pala tjetër dhe ndërmjetësuesi/ja konfirmimin e marrëveshjes së arritur më parë për kontestin e zgjidhur.⁷⁶ Pavarësisht që ndërmjetësuesi/ja nuk e ruan marrëveshjen e arritur në ndërmjetësim ai/ajo është i/e obliguar që të mbajnë raport lidhur me evidentimin për të gjitha rastet të cilat i ka ndërmjetësuar, natyrën e rasteve të zgjidhura dhe të pazgjidhura dhe palët në procedurë.⁷⁷

Ndërprerja dhe përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit online

Ndërmjetësuesi/ja ndërprejnë procedurën e ndërmjetësimit online nëse vëren se në mes palëve ka elemente të dhunës në familje apo ka të meta në shprehjen e vullnetit të lirë të palëve përmes dhunës ose kanosjes. Ndërmjetësimi online përfundon në rastet kur arrihet marrëveshja në mes të palëve; kur pala heqë dorë nga ndërmjetësimi; kur ndërmjetësuesi/ja përcakton se vazhdimi i ndërmjetësimit nuk do të ishte produktiv; kur palët nuk arrijnë marrëveshje.

Procedura e ndërmjetësimit nuk zbatohet për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në pajtim me Ligjin kundër Dhunës në Familje ose për çdo kontest apo mosmarrëveshje për të cilën është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent dhe ato që bien në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik.⁷⁸ Në rastet kur ekzistojnë elementet e dhunës në familje, ndërmjetësuesi/ja duhet të ndërpresë procedurën e ndërmjetësimit dhe t'i njoftojë palët për arsyen e ndërprerjes si dhe udhëzojë palët për ndjekjen e procedurave në pajtim me legjislacionin në fuqi.⁷⁹ Kjo duhet të ndodhë pa marrë parasysh se në çfarë faze gjendet procedura e ndërmjetësimit online dhe e njëjta vlen nëse ka të meta në shprehjen e vullnetit të lirë të palëve përmes dhunës ose kanosjes. Kur bëhet ndërprerja, ndërmjetësuesi/ja duhet të hartojë raport për arsyet e ndërprerjes dhe lëndën e kthen tek gjyqtari/ja i/e çështjes apo tek prokurori/ja për të vazhduar me procedurë të më tutjeshme.⁸⁰ Po ashtu, secila palë mund të heqë dorë nga ndërmjetësimi online në çdo moment.


⁷⁶ Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ, Neni 13.2

⁷⁷ Po aty, Neni 13.1 dhe Neni 14

⁷⁸ Shih: Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Neni 3.3; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 3.6; si dhe Udhëzimin e Kryeprokurorit të Shtetit për Mosdërgim në Ndërmjetësim të Rasteve të Dhunës në Familje (27.05.2021).

⁷⁹ Shih Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës, Neni 7.8

⁸⁰ Shih Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 11; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Neni 11



Vlen të ceket që Neni 34 i Ligjit Nr. 08/L – 022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike, përcakton edhe përjashtimet e përdorimit nënshkrimit elektronik, që ndërlihen edhe me ndërmjetësimin online, sipas të cilit nënshkrimi elektronik nuk mund të përdoret në rastet e mëposhtme: në fushën e së drejtës familjare dhe të trashëgimisë, të cilat u nënshtrohen kërkesave të veçanta ligjore; në veprimet ligjore për të cilat kërkohet legalizim publik, akt noterial ose autorizim nga gjykata; në veprimet ligjore që lidhen me garancinë pasurore për lirimet me kusht; kurdoherë kur me ligj të veçantë nuk lejohet përdorimi i nënshkrimit elektronik.

Ndërmjetësimi online përfundon në rastet e mëposhtme:

- › kur arrihet marrëveshja në mes të palëve dhe marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit online është e përmbarueshme;
- › kur pala heqë dorë (tërhiqet) nga ndërmjetësimi;
- › kur ndërmjetësuesi/ja përcakton se vazhdimi i ndërmjetësimit nuk do të ishte produktiv;
- › kur palët nuk arrijnë marrëveshje për zgjidhjen e kontestit apo mosmarrëveshjes së tyre brenda afatit të paraparë me ligj.


Efekti juridik i marrëveshjes së arritur në ndërmjetësimin online

Marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit online, është obligative vetëm për palët që janë në kontest apo mosmarrëveshje dhe vetëm për objektin e marrëveshjes, dhe kjo marrëveshje është dokument përmbarues dhe konsiderohet ujdë gjyqësore. Kundër marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim online, palët nuk kanë të drejtë ankese. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësimin online, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me procedurë gjyqësore.

Marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit online, është obligative vetëm për palët që e kanë arritur atë dhe vetëm për objektin e marrëveshjes.⁸¹ Kjo marrëveshje e arritur në procedurën e ndërmjetësimit konsiderohet ujdë gjyqësore dhe është e përmbarueshme në qoftë se kredia të cilën duhet përmbushur sipas saj është bërë e arritshme.⁸² Nëse lënda është referuar nga gjykata, marrëveshja e arritur me shkrim i dërgohet gjykatës gjegjësisht i dërgohet gjyqtarit/es të kontestit apo mosmarrëveshjes për miratim, i/e cili/a pas vlerësimit nëse i plotëson kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi, me aktvendim të veçantë apo me vendosjen e vulës së gjykatës, e miraton të njëjtën, e cila pas miratimit fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë. Pas kësaj ajo fiton edhe fuqinë

⁸¹ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 14; Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, Nenet 22, 23, 25 si dhe Udhëzuesin me Modelet e Marrëveshjes së Ndërmjetësimit, USAID, Prill 2021

⁸² Shih Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, Nenet 22, 23, 25



e dokumentit përmbarues në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Klauzola e përmbarueshmërisë në marrëveshje vendoset sipas të njëjtave rregulla si në vendime të gjykatës. Nëse rasti është referuar nga prokuroria, marrëveshja e arritur me shkrim i dërgohet prokurorit/es, i/e cili/a pas vlerësimit të asaj marrëveshjeje, me aktvendim të veçantë e aprovon marrëveshjen, më pas marrëveshja dhe aktvendimi për pranimin e marrëveshjes së arritur me ndërmjetësim, i dërgohet kryeprokurorit/es të prokurorisë përkatëse, pas aprovimit të së cilit/ës e ka fuqinë e vendimit të formës së prerë. Nëse lënda është referuar nga organi kompetent administrativ, marrëveshja e arritur me shkrim duhet t'i dërgohet organit kompetent administrativ, e cila pas aprovimit nga udhëheqësi/ja i/e organit administrativ, e ka fuqinë e dokument përmbarues. Nëse ndërmjetësimi fillon me vetë-inicimin e palëve, marrëveshja e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi/ja, e cila përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes, ka fuqinë e dokumentit përmbarues në përputhje me Ligjin për Procedurën Përmbarimore.⁸³


Por duhet pasur parasysh që gjyqtari/ja me aktvendim të veçantë mund të anulojë marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur konstaton se ajo është lidhur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kur pala dëshmon-argumenton se e njëjta është lidhur pa vullnetin e lirë dhe të plotë të tij/saj. Po ashtu, prokurori/ja që ka referuar rastin mund të anulojë marrëveshjen e arritur në ndërmjetësim, kur konstaton se është lidhur në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe kur ka të meta të vullnetit.

Kundër marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët nuk kanë të drejtë ankese. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me procedurë gjyqësore.

III. LISTA E BURIMEVE

- › Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 20 gusht 2018)
- › Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (Gazeta Zyrtare, Nr. 3, 31 janar 2013)
- › Ligji Nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë (Gazeta Zyrtare, Nr. 6, 08 shkurt 2017)
- › Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike (Gazeta Zyrtare, Nr. 6, 11 prill 2012)
- › Ligji Nr. 08/L - 022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike (Gazeta Zyrtare, Nr. 11, 23 dhjetor 2021)
- › Ligji Nr. 05/L -015 për Letërnjoftim (Gazeta Zyrtare, Nr. 36, 21 dhjetor 2015)


⁸³ Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 15; Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Neni 12 dhe Neni 17.4 si dhe Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Neni 16



- › Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare, Nr. 38, 20 shtator 2008)
- › Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur (Gazeta Zyrtare, Nr. 17, 18 tetor 2018)
- › Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (Gazeta Zyrtare, Nr. 27, 30 nëntor 2011)
- › Rregullore QRK - Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë (13.11.2013) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren QRK - Nr. 12/2018 (31.07.2018)
- › Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ
- › Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 04 /2021 për Tarifën e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës
- › Statuti (MD) Nr. 06/2020 i Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës
- › Rregullore (MD) Nr. 05/2020 për Punën e Kuvendit të Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës
- › Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës
- › Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 06/2019 për Trajnimin dhe Certifikimin e Ndërmjetësuesve
- › Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 05/2019 për Regjistrin e Ndërmjetësuesve
- › Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 04/2019 për Mbikëqyrjen, Përgjegjësinë dhe Procedurën Disiplinore të Ndërmjetësuesve
- › Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 03/2019 për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës
- › Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave
- › Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria
- › Udhëzim Administrativ QRK - Nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale
- › Rregullore Nr. 05/2013 për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta
- › Udhëzues për Lëndët e Gjykatave të Përshtatshme për Ndërmjetësim (Këshilli Gjyqësor i Kosovës Shkurt 2020)
- › Protokoll për Referimin e Rasteve në Ndërmjetësim (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 01.03.2022)
- › Udhëzim për Mosdërgim në Ndërmjetësim të Rasteve të Dhunës në Familje, (Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 27.05.2021)
- › Vendimi Nr. 82/2020 (30.04.2020) i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për Përdorimin e Metodës Online të Procedurës së Ndërmjetësimit në Gjykatat e Republikës së Kosovës
- › Directive 2008/52/EC of the European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on certain aspects of mediation in civil and commercial matters (Direktiva 2008/52/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 21 maj 2008 në Disa Aspekte të Ndërmjetësimit në Çështje Civile dhe Komerciale)



- › Model Law on International Commercial Mediation and International Settlement Agreements Resulting from Mediation, 2018
- › Regulation (EU) 2019/1150 of the European Parliament and of the Council of 20 June 2019 on promoting fairness and transparency for business users of online intermediation services
- › Besim M. Kajtazi: Përmbledhje legjislacioni për ndërmjetësimin në Republikën e Kosovës, Shkrola, Prishtinë, Prill 2022
- › Ndërmjetësimi në Kosovë: Vështrim dhe Rekomandime, Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC), 2021
- › Doracak - Ndërmjetësimi në Kosovë - Proceset dhe shkathtësitë, Partners - Kosova Center for Conflict Management, Laina Reynolds Levy, PhD, Partners for Democratic Change, Mars, 2011
- › Besim Kelmendi: Doracak për ndërmjetësimin si procedurë alternative gjyqësore për zgjidhjen e kontesteve mes palëve, Prishtinë 2020
- › Besim Kelmendi: Analizë Ligjore lidhur më risitë ligjore që kanë të bëjnë më procedurën alternative të ndërmjetësimin, Prishtinë, Tetor 2018
- › Hajrullah Mustafa: Ndërmjetësimi në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe efektshmeria pozitive e tij, Opinio Juris, Nr. 1/2015
- › Udhëzues trajnimi: Ligji për Ndërmjetësimin - USAID Prill 2012
- › Udhëzues me Modelet e Marrëveshjes së Ndërmjetësimin, USAID, Prill 2021
- › B. Biti, S. Fekolli, J. Çyrbja: Parimi i Konfidencialitetit në Proçesin e Ndërmjetësimin – Analize krahasuese Ndërmjet Ligjit Shqiptar, Ligjit Model UNCITRAL dhe Direktivës BE 200852EC



Mitrovicë/a

www.mediation-mitrovica.org

info@mediation-mitrovica.org

facebook.com/adrc.mediation